



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 15844 Prot.
15

Patos më 03.07.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 28.06.2024

I mbajtur sot më datë 28.06.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Armand Ahmetaj
2. Novrus Toska
3. Vjollca Kasaj
4. Liljana Mesutaj
5. Elmira Rama
6. Eduart Faslliaj
7. Erald Çepele
8. Klaudio Alisininaj
9. Ertilla Myrtaj
10. Albiona Lamaj
11. Artan Velçani
12. Smerald Hazizaj
13. Klarida Semanjaku

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit Z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve! Të nderuar këshilltarë, të nderuar qytetarë! Zhvillojmë këtë mbledhje në zbatim të nenit 53 pika 4 të nenit 56 pika 2 gërma a të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si nenit 59 të “Rregullores për Organizim dhe Funksionimin e Këshillit Bashkiak.

Kuorumi ligjor është i mbledhur, jemi 13 anëtar të këshillit prezent.

E deklaroj mbledhjen të hapur

Nisim me leximin e rendit të ditës i cili është hartuar në zbatim të ligjit dhe rregullores

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 14.06.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 14.06.2024.
- 4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Maj 2024”.

5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Maj 2024".

6- Projekt-vendim "Për përjashtimin nga pagesa e biletës së udhëtimit për personat me statusin e invalidit të punës, me statusin e të verbërit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik në linjën e transportit publik të miratuar me VKB nr. 28, datë 16.04.2024 Patos i Ri – Mustafa Matohiti-Margëlliç".

7- Informacion mbi rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nëse kemi ndonjë diskutim ose ndonjë korrigjim apo propozim për ndryshimin e rendit të ditës?

Nëse s'kemi kalojmë në votim.

Kush është dakord për miratimin e rendit të ditës?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Smerobll. Hoxhaj
Edmond Festliç
Armand Ahmetaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 15844 Prot.
16

Patos më 03.07.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.06.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 14.06.2024.

Armand Ahmetaj - Nëse ka ndonjë diskutim, pyetje apo sygjërim për korrigjim procesverbali?

Rafaela Xeba- Përshëndetje të gjithëve!

Në procesverbalin e mbledhjes datë 14.06.2024 është bërë një gabim material në prezencën e këshilltarëve ku është shënuar dy herë këshilltari z. Zejni Musaj ndërkohë që duhej pasqyruar këshilltarja zj. Enkelejda Ajazi e cila ishte prezent që në fillimin e mbledhjes pasqyruar dhe në videon audio që ne kemi. Korrigjimi përkatës është bërë dhe është bashkëlidhur procesverbalit. Faleminderit!

Eduart Faslliaj- Kisha dy pyetje dhe një konstatim. Unë jam anëtar i kryesisë dhe rendi i ditës i parashikuar nga ligji dhe rregullorja parashikon mbledhjen e kryesisë para çdo mbledhje. Në mbledhjen jashtë radhe nuk është thirrur mbledhja e kryesisë, për pasojë gjithçka që vjen nga mbrapa në gjykimin tim është e paligjshme, jo se kjo nuk mund të arrihet, kjo do të arrihet është fare e thjeshtë se shumicën e kryesisë ju e keni por të paktën ligji ju detyron ta thërrisni kryesinë, të bëni prezent rendin e ditës në kryesi, ta miratoni. Thirrjet një mbledhje jashtë radhe për një pikë të caktuar u shtuan dhe dy pika të tjera të cilën nuk ishte ndonjë emergjencë dhe ne mund ti trajtonim ato në mbledhjen e radhës siç e kemi tani. Dhe ne e kemi biseduar dhe në mënyrë personale, unë nuk dua ta bëj problem këtë gjënë por dua të tërheq vërejtjen që të operojmë në këtë institucion ashtu si ligji e parashikon dhe si kemi dakorduar në rregullore.

Armand Ahmetaj- Jam i detyruar të sqaroj, shqetësimi është i drejtë në një pikpamje të caktuar pasi ligjshmëria e procesit të mbledhjes së kaluar nuk çenohet në mënyrë absolute pasi janë kryer të gjitha procedurat që përcakton ligji dhe Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit Bashkiak. Pra siç ju thash dhe në mbledhjen e kaluar, mbledhja ishte jashtë radhe dhe ka afatet e veta. Ka patur një pamundësi për t'ju njofuar, jemi përpjekur pasi koha nuk na premtonte me telefon, nuk të kemi kapur dot në telefon, pjesa tjetër e kryesisë u mblodh, ne nuk na prisnin më afatet dhe e vazhduam procedurën. Pra dua të them që procedura është e ligjshme.

Faleminderit!

Nuk do të ndodhi më, do mundohemi që herën tjetër ti shfrytëzojmë të gjitha mundësitë.

Nëse ska pyetje ose sygjërim në bazë të nenit 77 të rregullores e konsiderojmë të miratuar unanimisht procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Eduart Faslliaj- Hidhe në votim

Armand Ahmetaj- Neni 77 i rregullores përcakton që nëse nuk kemi ndonjë propozim për korrigjimin e procesverbalit quhet e ezauruar ose i miratuar automatikisht por mund ta hedhim dhe në votim.

Eduart Faslliaj- Për sa kohe e kemi pikë të rendit të ditës themi pro, kundër dhe abstenim.

Armand Ahmetaj- E kemi kaluar kështu gjithmonë.

Eduart Faslliaj- Jo nuk e kemi kaluar.

Armand Ahmetaj- Po pra. Po ti nuk mund të votosh kundër se nuk ke qënë dhe prezent.

Eduart Faslliaj- Unë kam gjithë të drejtën time që të votoj kundër.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord?

Miratohet me 12 vota pro. 1 Kundër, abstenim ska.

SEKRETARE


Refaela Xeba



Smereta Hoxha
Eduart Faslliaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1584 Prot.
17

Patos më, 03 07.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.06.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 14.06.2024

Armand Ahmetaj- Fjala për Refaelën!

Refaela Xeba- Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 14.06.2024 janë marrë gjithsej 3 vendime. Vendimi nr. 47, nr. 48 dhe 49.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vendimi nr. 47 datë 14.06.2024 i është përcjell prefekturës për verifikim dhe na ka ardhur ardhur përgjigja se është në përputhje me ligjin.

Armand Ahmetaj- Po faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pikën e radhës

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerolal Bozari
Edmond Posthys

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1548 Prot.

13

Patos më 03 .07.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.06.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin maj 2024”.

Armand Ahmetaj- Për këtë pikë komisioni i Ekonomisë është mbledhur, e ka shqyrtuar dhe ka vendosur ta kaloj për shqyrtim në mbledhjen e këshillit bashkiak.

Armand Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje? Diskutim?

Atëherë kalojmë në votim. Kush është dakord për pikën e katërt?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1547 Prot.
13

Patos më 03 07.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.06.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Maj 2024”.

Armand Ahmetaj– Po e njehta gjë dhe për këtë pikë komisioni është mbledhur, e ka shqyrtuar dhe ka vendosur ta kaloj për shqyrtim në mbledhjen e këshillit bashkiak.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerdet Hoxhi
Eshla Moxhaj
Edmond Flo
KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1567 Prot.
13

Patos më 03.07.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.06.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për përjashtimin nga pagesa e biletës së udhëtimit për personat me statusin e invalidit të punës, me statusin e të verbërit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik në linjën e transportit publik të miratuar me VKB nr. 28, datë 16.04.2024 Patos i Ri – Mustafa Matohiti-Margëllic”.

Armand Ahmetaj- I lutem ekzekutivit.

Çajup Refitaj- Drejtor, Drejtoria e të Ardhura Vendore.

Ashtu si u paraqit në pikën gjashtë të rendit të ditës drejtoria e të Ardhurave Vendore ka propozuar nisur nga kërkesat verbale që ka pasur nga grupet vunerabël, ku bëjnë pjesë invalidet e punës, të verbërit, invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik për përjashtimin nga bileta e udhëtimit për linjën e transportit publik të miratuar me vkb nr. 28, datë 16.04.2024. Kjo linjë tashmë është funksionale natyrisht drejtoria u konsultua me të gjitha dispozitat ligjore të cilat përjashtojnë këto kategori nga pagesa e transportit të udhëtarëve.

Këtu është marrë për bazë ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, në nenin 4, të tij ka përcaktuar se: “Invalidët paisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Dëshmia lëshohet nga Shoqata e Invalidëve të Punës në bazë të KMCAP”. Pra, bazuar në ligjin e sipërcituar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për paisjen e invalidit të punës me dëshminë zyrtare të identifikimit është Shoqata e Invalidëve të Punës, kompetencë që i buron drejtpërdrejtë nga ligji. Lidhur me lehtësirat e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar pa biletë në transportin urban qytetas, sepse kemi dy raste të parashikuar në ligj, kemi rastin kur përjashtohet nga bileta e udhëtimit kjo kategori dhe rastin ndërqytetas kur ligji parashikon 50% të vlerës vajtje ardhje me një biletë.

Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e uljes. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta. Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e invalidit të punës, të verbërit,invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi dokumentin provues specifik. Në këtë kontekst, se cila shkresë konsiderohet dokumet provues, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse. VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit përkatës librezën , si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. 22 Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore i ndryshuar.

Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", ligjin nr. 37/2014 "Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore".

Lidhur për sa më sipër i parashtrijmë këshillit bashkiak përjashtimin nga bileta së udhëtimit për personat me statusin e invalidit të punës, me statusin e të verbërit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik në linjën e transportit publik të miratuar me vkb nr. 28, datë 16.04.2024 Patos i Ri – Mustafa Matohiti-Margëlliç.

Për përfitimin e këtyre lehtësirave kategorit e personave të përcaktuar në projekt vendim, duhet të jenë të pajisur:

- Invalidët e punës, të jenë të pajisur me KMCAP dhe Libreza Invalidi të leshuar nga Shoqatat në të cilën ata janë anëtar.
- Të verbërit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të jenë të pajisur me KMCAP Libreza të leshuara nga Ministria e Shëndetësis dhe Mbrojtjes Sociale.

Vetëm pas paraqitjes së këtyre dokumentave pranë faturisteve apo shoferve të linjës do të meret masa e përfitimit.

Eduart Faslliaj- Kisha dy pyetje

Invalidët e punës duhet të kenë dokumentin e kempit që tja paraqesin shoferit të tij dhe tetraplegjikët dhe të verbërit dokumentin e leshuar nga bashkia. Mjeti jonë i transportit që kemi, brenda mundësive që patëm nëse kemi mundësi në gjykimin tim ta rregullojmë nuk ka vend për tetraplegjikët, skemi as se si ti hipim dhe as ti akomodojmë. Ne na duhet një mjet më i madh. Ai mjet nuk i përballon dot. Unë kam parë që gjysmat e njerëzve ngelen jashtë. Ndoshta blerja e një mjeti më të madh do t'ja krijoj mundësinë për akomodimin e këtyre peronave.

Doja të dija në rastet kur e kryejnë shërbimin operatorët, për pjesën që ju hiqet për përjashtimin e personave ajo pjesë e parave që ju mungon atyre kompesohet nga biznesi lokal? Si e parashikon ligji?

Kryetari i Bashkisë- Nuk kompesohet.

Për pjesën e furgonit ke të drejtë por para muajit shtator ne nuk e bëjmë dot një gjë të tillë. Në shator do të shohim mundësinë për të marrë një mjet më të madh dhe në orët e fluksit do përdorim atë mjet që është më i madh dhe në orët e tjera atë mjet që kemi por jo para shtatorit, do shohim ku kemi çlirime fondi që mund ti përdorim. Në shator do ta shohim pjesën e një mjeti më të madh mbase me njëzetë vende ose gjshtëmbëdhjete. Më përpara është e pamundur.

Rëra bituminoze u hoq nëse do të shtroheshin disa rrugë me asfalt u bë zbritje tek pjesa e asfaltit që të meret rërë që të bëhet ajo rrugë pasi kostoja për të shtuar me asfalt rrugën nga Siqeca në Drenie është shumë e lartë dhe e menduam më të arsyeshme.

Eduart Faslliaj- Kryetar faleminderit për kohën që po më kushtoni por mendoj se nuk ma kushtoni mua por transparencës dhe detyrimit qytetar. Fshati Siqecë ishte një nga njëqind fshatrat që qeveria kishte parashikuar nga këto fshatrat turistike. Pritej për investime madhore dhe u katandisëm tek rëra bituminoze. Nuk e di çfarë ndodhi?

Kryetari i Bashkisë- Në mbledhjen e kaluar kishte komplet planrilevimin dhe planvendosjen se cila pjesë e rrugës është e përfshirë për tu shtuar dhe gjithë preventivi sa duhet për tu shtruar komplet ajo si sipërfaqe. Po ti shohesh materialet i ke atje. Madje tani që do zbresim ti tregoj unë. Rëra bituminoze nuk është për Siqecën, fillon në Siqecë ku mbaron rruga aktualisht po përfshihet më shumë rruga e Drenies sesa e Siqecës.


Armand Ahmetaj- Faleminderit! Ndonjë pyetje? Atëherë meqënëse nuk kemi pyetje kalojmë në miratimin e pikës gjashtë, projekt vendim "Për përjashtimin nga pagesa e biletës së udhëtimit për personat me statusin e invalidit të punës, me statusin e të verbërit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik në linjën e transportit publik të miratuar me VKB nr. 28, datë 16.04.2024 Patos i Ri – Mustafa Matohiti-Margëlliç".

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1570 Prot.

Patos më 03 .07.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 28.06.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Informacion mbi rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Armand Ahematj- I lutem ekzekutivit.

Ekzekutivi –Ernesta Hamiti relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Përsëritje!

Kontrolli i Lartë i Shtetit kreu auditimin financiar dhe përputhshmërinë për Bashkinë Patos për periudhën janar-dhjetor 2023. Auditimi u fokusua në disa çështje ndërkohe 4 prej të cilat më kryesore i kemi paraqitur dhe tek informacioni përmbledhës. Pika e parë lidhet me planifikimin e të ardhurave, realizimin dhe monitorimet e buxhetit. Në përfundim nga auditimi u konstatua se të ardhurat për vitin 2023 janë realizuar në masën 84% kurse shpenzimet për vitin përkatës në masën 79%. Për sa i përket pasqyrave financiare veprimeve dhe transaksioneve të kryera gjatë këtij viti u konkludua se ato janë në përputhje me bazën ligjore që rregullon fushën e kontabilitetit dhe financat publike për sektorin vendor. Kemi dy diferencë në dy llogari. E para është një nënvlerësim për llogarinë debitor të ndryshëm e cila lidhet kryesisht me moskontabilizimin e debitorëve familjar dhe pjesa tjetër lidhet me një mbivlerësim për llogarinë 466 e cila është “Kreditorë në ruajtje”.

Një çështje tjetër që u auditua nga KLSH ishin procedurat e prokurimit publik dhe zbatimi i kontratave.

Në përfundim u vu re së vetëm në pesë raste nga procedurat e prokurimit nuk ishte realizuar shpjegimi i specifikimeve teknike të vendosura dhe gjithashtu u realizuan volume në punime të pakryera për pesë kontrata.

Pika tjetër lidhet me lejet e ndërtimit dhe zhvillimit ku në tre raste janë konstatuar mangësi në projektin ndërtimor apo në dokumentacione të tjera shoqëruese.

Dhe pika e fundit ishte se sa ne kemi zbatuar rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kaluar i cili i përkiste periudhës 2019-2022. Ne e kemi hartuar planin e veprimit brenda afatit 20-ditor dhe kjo ka ndikuar që ne të respektojmë rekomandimet përveç dy rekomandive që janë aktualisht në proces zbatimi. Përsa i përket auditimit të kryer KLSH në përfundim la opionion të modifikuar që do të thotë që janë disa gabime të cilat nuk janë të përhapura dhe pjesa tjetër e veprimtarisë së institucionit është në përputhje me bazën ligjore në fuqi. U lanë disa masa për përmirësimin e veprimtarisë të cilat ne i pranuan dhe kemi hartuar planin e zbatimit. Kemi filluar nga puna sipas drejtorive përkatëse për zbatimin e rekomandimeve. Për më shumë informacion Raporti KLSH-së është i publikuar në faqen zyrtare.

Erald Çepele- Mirë do ishhtë të na ishhtë vënë i gjithë materiali në dispozicion.

Ernesta Hamiti- Është në faqen zyrtare tek KLSH.

Erald Çepele- Unë kam një pyetje më këto tetë masat disiplinore. Për çfarë janë konkretisht?

Ernesta Hamiti- Masat disiplinore lidhen me lejet e ndërtimit dhe specifikimet teknike të procedurat e prokurimit publik.

Armand Ahmetaj- Pyetje tjetër. Nëse nuk keni gjë tjetër e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Smeralda Hoxhaj
Erika Murdaj
Edmond Ferri

KRYETAR

Armand Ahmetaj

